



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Mars 2021

Nr: 139

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA  
PARTIA “ALEANCA KOMBËTARE” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS  
25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Partia “Aleanca Kombëtare” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Partia “Aleanca Kombëtare” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partia “Aleanca Kombëtare” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Partia “Aleanca Kombëtare” nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68/1 të Kodit Zgjedhor për zotërimin e 1 (një) mandati në Kuvend ose paraqitjen e listave mbështetëse me jo më pak se 5000 zgjedhësve në shkallë kombëtare.
2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;



3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Berat**, konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
9. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
10. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Fier**, konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;



11. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
12. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
13. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Lezhë**, konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;

Në bazë të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor, Partia “Aleanca Kombëtare”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

#### **VENDOS :**

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë” Aleanca Kombëtare” për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

